



## PROCESVERBALI

Mbledhja e Komitetit për Komunitete të Kuvendit Komunal të Rahovecit, e mbajtur me datë: **09.06.2022** me fillim në ora **10.00**. Këtë mbledhje e kryesoi kryesuesi i Komitetit për Komunitete z. **Bajram Morina**. **Kryesuesi – Fillimi** më lejoni të ju përshëndes të gjithëve për praninë tuaj në këtë mbledhje të Komitetit për Komunitete, përshëndes anëtarët e Komitetit për Komunitete për përfaqësuesit e OSBE-së. Ky është takimi i tretë për vitin 2022, për takimin e sotëm i kemi këto pikë të rendit të ditës:

### REND DITE

1. Aprovimi i procesverbali nga mbledhja e kaluar;
2. Informatë rreth realizimit të projekteve nga drejtoria e shërbimeve publike në vendbanimet ku jeton komuniteti joshumicë.
3. Planifikimi i vizitave në vendbanime ku jeton komuniteti joshumicë
4. Informatë nga zyra për komunitete dhe kthim
5. Të ndryshme

**Kryesuesi –** Para se të vendosim rendin e ditës në votim, kërkoj nga ju nëse ka dikush ndonjë vërejtje rreth procesverbalit nga mbledhja e kaluar. Mirëprat atëherë e vendosim në aprovim rendin e ditës, kush është për?... kundër?...abstenim?...konsideroj që në mënyrë unanime është miratuar procesverbalii nga mbledhja e kaluar. Kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës; **Informatë rreth realizimit të projekteve nga drejtoria e shërbimeve publike në vendbanimet ku jeton komuniteti joshumicë**. Ekzekutivi ka qenë i informuar, drejtori është i zënë për shkak të agjendës së ngjeshur, atëherë këtë pikë mund ta shtyejmë për seancën e radhës, ia dërgojmë ftesën drejtorit.

**Lendrit Qeli –** Më ka latur drejtori që te pjesa e raportimit tim të diskutojmë për bashkëpunimin që kemi edhe ku do të intervenojmë, po deshe mund ta diskutojmë atë pjesë.

**Kryesuesi – Faleminderit z. Lendrit** për informatë, ne drejtorit do t'i dërgojmë ftesën edhe në takimin e radhës, kalojmë në pikën e tretë të rendit të ditës; **Planifikimi i vizitave në vendbanime ku jeton komuniteti joshumicë**, kush dëshiron ta merr fjalën prej anëtarëve?

**Skender Hamza –** Përshëndetje, atëherë nëse ka ndokush të ketë ndonjë propozim rreth kësaj pike të vizitës së komuniteteve? Shqipja atëherë:

**Shqipe Kryeziu –** Përshëndetje për të gjithë, më pëlqej shumë kjo pikë e rendit të ditës, thjeshtë më shumë isha fokusuar te arsimi, te vizita e fëmijëve, inkurajimi, motivimi. Unë punoj në shkollën e mesme dhe kemi shumë pak famijë dhe më duhet e arsyeshme vizita në terren t'i bindim që shkolla është mbi të gjitha, unë mendoj kështu dhe nëse kam përkrahjen e juaj, të bëjmë vizita një ditë në

Brestoc, Krushë në këtë pjesë... pastaj në atë pjesë Fortesë, Xërxe e ku jetojnë në mënyrë të organizuar t'i takojmë fëmijët dhe prindërit e tyre që t'ia dijnë më shumë vlerën e arsimit.

**Skender Hamza** - E nderuar, tani fillon edhe procesi i regjistrimit të nxënësve nëse nuk gaboj?...

**Shqipe Kryeziu** – Po, pikërisht për këtë, klasat e nënta nesër e përfundojnë dhe po interesohem që ata ti biejmë në shkollë të mesme, të binden që normal të vijnë në shkolla të mesme me drejtime shumë të mira të njoftohen në bashkëpunim me drejtorinë e arsimit dhe thjesht ata të vijnë sepse nëpër shkolla fillore ata shkojnë, po nëpër shkolla të mesme nuk janë.

**Edona Kryeziu** – Pjesa e vizitave mendoj që duhet të jetë në menyrë vullnetare, në seancën e kaluar kam kërkuar që vizitat të jenë në vikend, po sa kom informacion është e pamundur një gjë e tillë.

**Skender Hamza** – Ju sygjeroj ta bëni një kalendar, cilën pjesë dëshironi ta viziton dhe cilën ditë?

**Shqipe Kryeziu** – Poenta është që këta që janë në klasë të nëntë, të vijnë në shkollë të mesme të lartë, të vazhdohet shkollimi më lartë... Të takohemi drejtpërdrejtë me ta dhe familjarët e tyre, të bisedojmë dhe t'i sugjerojmë për shkollim.

**Kryesuesi** – Unë kisha qenë i pajtimit të dakordohemi të gjithë anëtarët e komitetit për komunitete të caktojmë në datë si dhe vendit e takimit me prindërit e fëmijëve.

**Lendrit Qeli** – Një propozim, ndoshta nuk është e posaçme vetëm çështja e arsimit, mund të zgjerohemi pak edhe te çështja e infrastrukturës si dhe në problemet tjera që ballafaqohet komuniteti.

**Kryesuesi** – Në çoftëse kemi vendosur të dalim në takime jo nëpër shkolla, po në vendbanime, duhet ta bëjmë një kalendar psh; në lagjen e epërme, në pjesën e Anadrinisë ose në pjesën kah Brestovci, të takohemi me prindë dhe e shohim rezultatin se a kanë ambicie për regjistrim. Në muajin shtator kisha propozuar të dalim nëpër shkolla dhe ta shohim numrin e të regjistruarve.

**Shqipe Kryeziu** – Po e ceku edhe një herë, nesër e përfundojnë fëmijët, pjesën e parë të testin e kanë përfunduar, pjesën e dytë e kanë me datën 14, më pas dalin rezultatet dhe besoj që e kalojnë sepse janë të mirë në mësimë. Unë vet punoj në shkollën e mesme të lartë, ka fëmijë që shkon deri në klasën e 9-të, por nuk vjenë në shkollën e mesme të lartë, ne duhet t'iu tregojmë rëndësinë e shkollës, të fillojnë tani dhe ta përfundojnë në shtator.

**Kryesuesi** - Konsideroj që pika e tretë është aprovuar dhe kalojmë në pikën e 4-të; **Informatë nga zyra për komunitete dhe kthim, fjala është për Lendrit Qelin ...**

**Lendrit Qeli** – Përshtendetje për të gjithë, i nderuar kryesues, anëtarë të komitetit. Zyra komunale për komunitete dhe kthim, në periudha të ndryshme raporton në zyrën e kryetarit meqenëse kjo zyrë është pjesë e kabinetit të kryetarit, raportojmë në 4 periudha, raporti tre mujor, gjashtë mujor dhe përfundimtarin vjeqar. Meqenëse kemi hy në muajin qershor, po mundohem në pika të shkurtëra t'iu njoftojë për periudhën janar-qershor për punën dhe aktivitetet që ka realizuar zyra komunale për komunitete dhe kthim. Ky është njëri prej raporteve që ne zakonisht i dërgojmë për publikim me qasje edhe në web-sajtin zyrtar të komunës. Para raportimit po i listoj synimet kryesore të zyrës komunale për komunitete dhe kthim për vitin 2022.

Meqenëse zyra komunale për komunitete dhe kthim merret me riatdhesim, me kthim të qëndrueshëm dhe me mbrojtën e të drejtave të komuniteteve joshumicë, kemi listuar disa prej synimeve kryesore për vitin 2022 duke u bazuar edhe në planin e punës të përvjetshëm që e kemi. Në mënyrë që mos të jem shumë i gjatë në lexim, mund të iu dërgoj reportin edhe në email, sepse nuk e di a është i publikuar sepse nuk ka një javë që i kemi rapportuar zyrës së kryetarit. Atëherë kalojmë te pikat kryesore; u përmend arsimi, në komunë e Rahovecit vijojnë rrëth 100 nxënës nga komuniteti Romë, Ashkalinjë Egjiptianë, 3 nga komuniteti Romë, 77 nga komuniteti Ashkalinjë, 20 Egjiptianë. Gjashtë prej tyre vijojnë në shkolla të mesme, në të gjitha shkollat në komunën e Rahovecit, ndërsa sa i përket

komunitetit Serb, një pjesë e konsiderueshme e tyre vazhdojnë mësimin paralele që janë 80 nxënës, në shkolla të mesme janë 14, ndërsa në pjesën e parafilllore 33, që total i bie 127. Çështja e arsimit është primare për zyrën për komunitete, sidomos për komunitetet Romë, Ashkalinjë, Egjiptianë duke u bazuar në problemet që ata ballafaqohen si grupe të marginalizuara, zyra për komunitete çdo vit mbanë fushata sensibilizuese, fillimisht në regjistrimin e fëmijëve në klasë të para (që është shumë me rëndësi) sidomos regjistrimi në kohë, ndodhë që regjistrimin e bëjmë 5-6 ditë para shtatorit sepse edhe mund të ballafaqohemi si komunat e tjera me një klasë segregune (një klasë me të gjitha komunitetet). Fatmirësish në komunën tonë nuk kemi telashe të tilla si në komunat tjera, sepse në mbajmë fushata para kohës duke filluar prej majit e deri në qershor. Këtë aktivitet e realizojmë me përfaqësues të komunitetit, shoqerinë civile dhe me donatorët potencial që konsiderohen si OSBE dhe organizatat tjera dhe të njëjtën kohë edhe jemi partnerë. Ne marrim informata nëse dikush ka telashe në procesin e regjistrimit, vitin e kaluar një pjesë e fëmijëve nuk kanë pasur mundësi financiare çoftë edhe ta nxjerrin certifikatën e lindjes për regjistrim, por në bashkëpunim me një organizatë ndërkombëtare që funksionon në Kosovë kemi arritur që gjithë atyre fëmijëve t'u mbulojmë këtë lloj shpenzimi modest. Një aktivitet i ngajshëm mund të realizohet me të gjithë ata që e përfundojnë fillore dhe të kenë mundësinë të kyçen në shkollën e mesme, në mënyrë që përmes këtij sensibilizimi t'i vetëdijësojmë ata që shkolla e mesme është shumë e rëndësishme. Në këtë drejtim përpos gatishmërisë së zyrës tonë, jam i gatshmëm të bashkëpunoj edhe me organizatën "Voice of Roma, Ashkali and Egyptians" njëra ndër organizatat që jep edhe bursa për nxënësit e shkollave të mesme, një motiv shtesë, përpos asaj që ne punojmë. Pikë tjetër që ndoshta është edhe informatë për ju, në ditëve në vazhdim ne presim të nënshkrujmë një marrëveshje të mbështetjes nga IOM me të cilët do të realizojmë një projekt që ka për qëllim formimit e një qendrë të komunitetit me bazë në shkollë e cila konsiderohet si qendër e arsimit me bazë në komunitet që më herët kemi pas diçka të ngajshme që është implementuar nga SHL Kosova si OJQ, por fatkeqësisht qëndrueshmëria ka qenë e dobët shkaku i mungesës së donatorëve dhe është dashur që qendra të mbyllët. Mungesa e kësaj qendre ka sjellë rezultate jo të mira sepse qëllimi kryesor ishte nëse një femijë shkon në shkollë, kur të kthehet në shtëpi ka problem t'i bëjë detyrat e shtëpisë sepse mund të ballafaqohet me atë gjendje që prindi i vet mund të jetë analfabet dhe nuk ka kush t'i ndihmojë, kjo qendër ka pasur këtë lloj roli të gjejë metodën më të mirë të avancimit, që fëmija ta rritë kapacitetin dhe nivelin e përmirësimit të notave në rang me nxënësit tjerë. Shembull i mirë është Ratkoci që ka një qendër të tillë, që financohet në bashkëpunim me drejtorinë e arsimit dhe Voice of Roma, Ashkali and Egyptians, fat i mirë është që tanë edhe me udhëzim administrativ ministria e arsimit e ka për obligim mbështetjen e këtyre qendrave dhe qëndrueshmërinë e tyre. Kjo rritë mundësinë të kalojmë edhe me një qendër tjetër si psh; në lagje të epërme ku jeton një numër i madh i komuniteteve dhe kjo qendër bazën do ta ketë në shkollën Gëzim Hamza – Piktori me kosto diku afér 20.750 euro (inventarizim), 14.000eu mbështetje nga IOM, 6750eu prej fondeve tona (zyrës tonë). Kjo qendër do të ketë rol të madh te fëmijët që kanë ngecë në mësim, do të shfrytëzohet për aktivitete, për procese të vaksinimit si dhe çështje tjera. Sa i përket arsimit, ky është fokusimi ynë këtë vit, ka qenë projekt i kushtueshëm dhe është bërë problem të gjejmë mbështetje financiare sepse shumica e donatoreve nuk po e shohim më si prioritet investimin në aktivitete që kanë të bëjnë me komunitete, ndoshta edhe periudha 23 vjeçare pas luftës e ka bërë të veten, të tërhiqen dhe të fokusohen dikah tjetër. Detaji i fundit për arsim, ne kemi ngritë vëtëdijen që sa më shumë të rinjë e të reja të aplikojnë për bursë, pavarësisht që nuk jam i kënaqur me numrin e përsituesve sepse nuk e di çka ka ndodhë te pjesa e aplikimit (edhe pse i kemi informuar me detaje) kanë hezituar për aplikim fatkeqësisht, rrjetet sociale po i shfrytëzojnë më shumë për "Fun" e jo për të marr vesh rrëth aplikimit, numri është shumë minimal që kanë përsituar, besoj që për shkak të neglizhencës. Pika tjetër; shëndetësia dhe mirëqenia sociale,

zyra komunale për komunitete dhe kthim në kuadër të kabinetit të kryetarit kemi nënshkruar një marrëveshje me "Voice of Roma, Ashkali and Egyptians" për herë të parë për renovimin e disa shtëpive të komunitetit Romë, Ashkalinjë, Egjiptianë që kryesisht e kanë vendbanimin shumë të dobët (infrastrukturën), deri më tani prej disa aplikuesve kemi marrë disa kërkesa, ne kemi qenë edhe në vizitë dhe në bazë të komisionit 5 prej do të mbështeten, totali i mjeteve është 25.000eu që 10.000eu janë donacion, 15.000eu në bashkëpunim në mes zyrës tonë dhe kryetarit. Për shkak të shtrenjtimit të madh të materialit ndërtimor ne është dashur t'i shikojmë mundësitë me llupë që t'iu dërgojmë materialin e nevojshëm përsituesve, prej këtyre 5 përsituesve, 2 do të jenë shtëpi të reja prej 60 m katror pjesa tjetër do të jetë për renovime të kulmave, banjove (lloj aneksi) etj... Meqenëse po flasim për shëndetësinë dhe mirëqenien sociale është që për herë të parë UNICEFI fillon me një program në komunën e Rahovecit në bashkëpunim me organizatën "Balkan Sunflowers" që ka të bëjë kryesisht me vaksinimin e fëmijëve në moshën e duhur (0-7 vjeçar), ku edhe çalojnë në këtë sferë të vaksinimit tri komunitetet, për herë të parë ky bashkëpunim ka filluar, përpos që ka rezultate shumë të mira, na kanë dhënë hapësirën e punësimit të dy personave që vijnë nga radhët e komunitetit dhe e bëjnë punën në terren. Kalojmë menjëherë në infrastrukturë, sepse riatdhesimin ka më shumë në kuptimin e punës administrative që ne e bëjmë me palët dhe i procesojmë në ministrinë për komunitete dhe kthim dhe në ministrinë e punëve të brendshme, pra pjesën administrative e bëjmë ne, ndërsa vendimin e merr niveli qendror... Në infrastrukturë ekziston një mbështetje e mirë sidomos viteve të fundit e sidomos në këtë vit komuna e Rahovecit ka pas një mbështetje prej 70.000eu prej MAPL-së për vendbanimet e komuniteteve joshumicë (lagjja e epërme, komplekt deri në fund). Me të njëjtën ministri kemi pas fatin të përfitojmë edhe një donacion tjetër në vlerë prej 40.000eu që do të fillon shumë shpejt, matjet dhe procedurat janë kryer, presim ditëve në vazhdim të fillojmë, ka të bëjë përsëri me lagjen e epërme sepse është një ndër vendbanimet më multietnike me të gjitha komunitetet (Romë, Ashkalinjë, Egjiptianë, Serb, Shqiptarë). Në fund kisha dashur të potencoja që për herë të parë e Rahovecit, gjegjësisht zyra jonë është duke hartuar një dokument ose politikë komunale të veten e cila për herë të parë do të ketë një lloj strategjje për zhvillimin e pozitës së komuniteteve joshumicë në vend, me precizim të të gjitha komuniteteve joshumicë, pra jo dokumentacione si më herët që i kemi pas të derivuara prej nivelit qendror veçmas për Romë, Ashkalinjë, Egjiptas, e veçmas për një komunitet tjetër. E kemi pas një konsultim që kemi mbështetjen nga OSBE të cilët i falënderoj, ndërsa porsa ti vendoset kosotja dhe i kalon të gjitha procedurat, komitet për komunitete (KK), KPF dhe në kuvend, ne kemi planifikuar në shtator të mbajmë një konferencë të donatorëve që për momentin e kemi një dritë të gjelbërt nga ambasada e Kanadës që do ta mbështet procesin e konferencës.

**Kryesuesi – Ju faleminderit z.Lendrit, kalojmë në pikën e radhës; Të ndryshme...**

**Edona Kryeziu – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, i nderuari kryesues Morina, të nderuar anëtarë të komitetit për komunitet dhe të gjithë të tjera që janë prezent në këtë seancë.**

Sot kam zgjedhur të ngrisë një çështje që është mjaftë shqetësuese, çuditërisht çështja ime u diskutua edhe më herët, më konkretisht dëshiroj të flasë për sfidat në sistemin e arsimit të komuniteteve Romë, Ashkalinjë, Egjiptas. Komuniteti joshumicë shpeshherë ballafaqohet me probleme të shumta, përvëç gjendjes së rëndë ekonomike, problemeve me vendbanim ata kanë vështirësi edhe në arsim. Një numër i vogël i tyre vijojnë shkollimin, ndërsa pjesa tjetër e ndërprejnë herët apo më mirë të themi që nuk e fillojnë fare. Ne jemi mbledhur këtu që këto probleme të eleminojen dhe ndikimi ynë të shtrihet me qëllim që të bëhet gjithëpërfshirja e të gjithë nxënësve në sistemin e arsimit. E di që në komunën tonë ekziston ekipi për parandalim – reagim kundër braktisjes dhe mosregjistrim të fëmijëve në shkollë, në këtë rast kam zgjedhur 3 pyetje për zyrën për komunitete dhe kthim; Sa është funksional ky ekip? Sa ka

gjetur përkrahje komuniteti joshumicë nga komuna e Rahovecit specifisht nga partia në qeverisje? Sa jeni duke punuar ju si zyrë përritjen e numrit e nxënësve nëpër shkolla?... Faleminderit shumë.

Te pyetja e parë dhe te e treta i morën përgjigjet gjatë seancës, te e dyta mundësish kërkoi përgjigje! Sa keni gjetë përkrahje si komunitet joshumicë nga komuna e Rahovecit, specifisht nga partia në qeverisje?

**Lendrit Qeli** – Faleminderit Edonë, zyra jonë është pjesë e kabinetit të kryetarit kjo nënkuption që çdo kryetar që vjen na jemi pjesë aty sepse jemi staf civil. Deri më tani padyshim që kemi bashkëpunim shumë të mirë me të gjitha drejtoret, funksionon edhe mekanizmi aty ku shohim probleme menjëherë reagojmë, sa kam informatë unë deri më tani nuk kemi pas asnjë problem të theksuar e që nuk kemi intervenuar.

**Kryesuesi** – Faleminderit z.Lendrit, konstatoj që takimi i sotëm është i mbollur, shihemi në takimin e radhës, faleminderit për pjesëmarje.

Procesmbajtësi  
  
 Agim Hoti

